



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.842/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit Hajrush Stublla, kandidat i pavarur, në Komunën e Lipjanit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.842/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit Hajrush Stublla kandidat i pavarur, në Komunën e Lipjanit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, me të cilën ka kërkuar Rinumërimin e votave në të gjitha Qendrën e votimit në Komunën e Lipjanit.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.842/2021, i ushtruar nga Hajrush Stublla Kandidat i pavarur për Kuvend Komunal në Komunën e Lipjanit, me të cilën pretendon se KQZ në faqen zyrtare gjate publikimit të rezultateve për secilin kandidat ka pasur 120 vota, ndërsa me datën 03.11.2021 gjate publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja figurojnë 183 vota, më tutje pretendon se duke pasur parasysh se ka parregullsi, kërkon nga PZAP që të rinumëroj të gjitha vendvotimet në Komunën e Lipjanit.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal, kandidat i pavarur, Hajrush Stublla, kërkon rinumërimin e të gjitha qendrave të votimit në Komunën e Lipjanit. Paneli pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Hajrush Stublla Kandidat i pavarur për Kuvend Komunal më të cilin apel kërkon që të rinumërohen të gjitha qendrat e votimeve është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, i njëjti nuk ka ofruar asnjë dëshmi qoftë formular apo deklaratë, që dëshmojnë ato pretendime të cilat pretendon se nuk i kanë dalë votat, por vetëm thekson në mënyrë të përgjithshme se ka mungesë të votave si kandidat i pavarur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime të votave gjatë publikimit të rezultateve nga ana e KQZ-së, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tije nuk mbështetën në asnjë provë konkrete dhe të njëjtat janë vetëm pretendime dhe nuk argumentohen me asnjë prove.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.842/2021 më datën 06.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.